



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

*Dokument Parlamentar*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më.27.06.2023

**RAPORT PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VLERËSIMIN E  
VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2022  
DHE MIRATIMIN E PROJEKTREZOLUTËS PËR VLERËSIMIN E  
VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2023**

Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e zhvilluara në datat 7 dhe 27 Qershor 2023, mori në shqyrtim raportin vjetor të punës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022 si dhe projekt –rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” për vitin 2022”.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në zbatim të nenit 181, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ka paraqitur raportin vjetor për punën e tij për vitin 2022, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në mbledhjen e datës 7 Qershor 2023, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, organizoi seancë dëgjimore me z. Alfred Balla, Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Z. Balla gjatë prezantimit të raportit në mbledhje bëri një analizë gjithëpërfshirëse të çështjeve kryesore të punës dhe veprimtarisë institucionale, problematikave dhe rezultateve të arritura në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, trajtoi marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndërinstitucional e ndërkombëtar, si dhe theksoi veprimet e ndërmarra në funksion të transparencës ndaj opinionit publik, medias dhe shoqërisë civile.

Zoti Balla, referoi se Këshilli ka punuar në drejtim të ngritjes në detyrë të drejtuesve të prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, procedurave të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele të prokurorëve, ngritjen në detyrë të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, miratimin e disa akteve nënligjore të rëndësishme për karrierën e çdo prokurori, të cilat janë finalizuar me sukses.

Kryetari vlerësoi impaktin pozitiv që ka pasur në përmbushjen e detyrave funksionale të këshillit bashkëpunimi ndërinstitucional me të gjithë aktorët kombëtarë, kryesisht në funksion të efikasitetit e përmirësimit të praktikave të përbashkëta dhe në unifikimin e procedurave të caktuara, si dhe bashkëpunimin produktiv me faktorët ndërkombëtarë të përfshirë dhe të angazhuar në procesin e forcimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Një arritje për Këshillin, ka qenë gjithashtu miratimi i Rregullores “*Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve*”, si momenti i parë për fillimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, duke u bazuar në kritere objektive, të përcaktuara në mënyrë të detajuar në këtë rregullore dhe anekset që e shoqërojnë atë.

Zoti Balla në përmbyllje të analizës së aktivitetit të Këshillit, trajtoi nivelin e zbatimit të standarteve, masave dhe detyrave të ngarkuara kundrejt institucionit që përfaqëson si dhe prioritet e përcaktuara për Këshillin e Lartë të Prokurorisë për t’u realizuar përgjatë vitit 2023, gjithashtu, në përmbyllje të prezantimit parashtrori në hollësi edhe një analize të kryer nga Këshilli mbi situatën e prokurorive në të gjithë vendin.

Pas përfundimit të prezantimit të raportit vjetor, relatori e çështjes, i caktuar nga komisioni Z. Saimir Hasalla parashtrori mendimin e tij mbi raportin duke evidentuar problematikat dhe vlerësimet për veprimtarinë e KLP-së gjatë vitit 2022.

Pas prezantimit të mendimit të relatorit të çështjes, seanca dëgjimore vijoi me një sërë pyetjesh të deputetëve, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, mbi veprimtarinë e institucionit për vitin 2022.

Në mbledhjen e datës 27 Qershor 2022, në Komision u diskutua dhe për projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022”. Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022”, sipas propozimit të relatorit, duke pasqyruar në versionin final edhe sugjerimet konsultuar me institucionin me qëllim paraqitjen për votim seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Bashkëlidhur teksti integral i Projekt-Rezolutës.

**RELATOR**

**Saimir HASALLA**

**KRYETARE**

**Klotilda BUSHKA**